



NJOFTIM

për realizimin e trajnimit dhe mbajtjen e provimit profesional për ushtrimin e veprimtarive të brokerimit në sigurime

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve informon opinionin se do të organizojë trajnimin dhe mbajtjen e provimit profesional për ushtrimin e veprimtarive të brokerimit në sigurime (në tekstin që vijon: trajnim dhe provim profesional për broker).

Trajnimi për broker në kohëzgjatje prej 9 ditësh (gjithsej 27 orë mësimore) do të zhvillohet **online** dhe do të realizohet në datat **09.09.2026 – 11.09.2026 dhe 14.09.2026-18.09.2026 dhe 21.09.2026** me orarin kohor prej orës 17-20.

Koha e saktë dhe orari i detajuar i leksioneve në kuadër të trajnimit, si dhe informacione më të hollësishme për mënyrën e mbajtjes së trajnimeve do të publikohen në faqen e internetit të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve përpara fillimit të trajnimit.

Pas përfundimit të trajnimit Agjencia do të realizojë dhënien e provimit profesional për broker. Datat për dhënien e provimit profesional për broker janë si më poshtë:

Pjesa e parë (pjesa teorike) më 07.10.2026 dhe 09.10.2026

Pjesa e dytë (pjesa praktike) më 28.10.2026

Kandidatët që nuk do të kalojnë në provimin profesional për broker me provimin e parë kanë të drejtë për të dhënë dy riprovime brenda 6 muajve nga data e përfundimit të trajnimit në afatet e mëposhtme:

Provimi i dytë

Pjesa e parë (pjesa teorike) më 5.11.2026 dhe 6.11.2026

Pjesa e dytë (pjesa praktike) më 24.11.2026.

Provimi i tretë

Pjesa e parë (pjesa teorike) më 4.12. 2026.

Pjesa e dytë (pjesa praktike) më 24.12.2026.

Të gjithë të interesuarit, **brenda datës 31.08.2026**, mund të paraqiten për pjesëmarrje në trajnimin dhe dhënien e provimit profesional për broker me parashtrimin e dokumentacionit vijues: (me shënimin: Aplikim për trajnim/ Kërkesë për dhënien e provimit për broker) në Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (adresa: rruga Maqedonia nr.25 – Pallati “Llazar Pop Trajkov”, kati i V, Shkup):



1. Formular të plotësuar – Aplikim për pjesëmarrje në trajnimin për broker/Kërkesë për dhënien e provimit profesional për broker (i aksesueshëm në faqen e internetit të Agjencisë ose në Arkivin e Agjencisë)
2. Kopje e letrënjoftimit;
3. Vërtetim respektivisht Diplomë për përfundimin e arsimit të mesëm (shkalla IV) ose shkallë më të lartë të arsimit, në original ose të noterizuar tek personi i autorizuar – noteri: dhe
4. Argument për kompensimin e paguar për pjesëmarrje në trajnimin dhe dhënien e provimit profesional për broker.

Nëse emri dhe mbiemri personal në ndonjë prej dokumenteve të përmendura më lart nuk janë identike me ato të përcaktuara në Aplikim / Kërkesë, personi gjithashtu duhet të paraqesë certifikatë martesë ose një vendim për ndryshimin e emrit respektivisht mbiemrit personal.

Kompensimi për të marrë pjesë në trajnimin dhe dhënien e provimit profesional për broker përcaktohet në Listën e Tarifave për përmbajtjen dhe vlerën e kompensimeve dhe tatimeve që i paguhen Agjencisë të Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe afatet e pagesave (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.147/2009, 149/2009, 154/2009, 20/2012, 130/2013, 1/2015, 22/2016, 16/2017 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.23/2020) dhe ka vlerën prej **14.000 denarësh**.

Argumenti për kompensimin e paguar duhet që të përmbajë të dhënat vijuese:

QËLLIMI I PAGESËS:	për trajnimin dhe dhënien e provimit për broker në sigurime (emër dhe mbiemër)
EMRI I PRANUESIT:	Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve – Shkup
BANKA E PRANUESIT:	Stopanska Banka SHA – Shkup
LLOGARIA:	200002007041251 ose
BANKA E PRANUESIT:	NLB Banka SHA -Shkup
LLOGARIA:	210065288480132
BANKA E PRANUESIT:	HALK BANKA SHA - Shkup
LLOGARIA:	270065288480139
BANKA E PRANUESIT:	Silk Roud banka SHA Shkup
LLOGARIA:	280122102174554

Trajnimi i brokerëve përfshin 9 (nëntë) fusha- module:



1. Bazat e menaxhimit të rrezikut dhe sigurimit;
2. Legjislacioni i sigurimeve;
3. E drejta tregtare dhe obligative
4. Ndërmjetësimi i Sigurimeve dhe Kodi i Etikës
5. Sigurimi i jetës
6. Sigurimi jo-jetë.
7. Aspektet financiare të aktivitetit
8. Regjistrimi i rriskut dhe ndërmjetësimi gjatë realizimit të dëmeve
9. Risigurimi

Përmbajtja e detajuar e secilit prej moduleve të trajnimit për broker është elaboruar në Kurrikulën e Provimit profesional për Broker të vendosur nga Agjencia dhe përmban vlerësimin, rregulloret dhe literaturën e nevojshme. Programi mësimor publikohet në faqen e internetit të Agjencisë së Mbiqëqyrjes së Sigurimeve.

Mënyra dhe procedura për mbajtjen e trajnimit dhe provimin profesional për broker përcaktohen në detaje në Rregulloren për mënyrën, procedurën dhe kushtet e mbajtjes së trajnimit dhe dhënien e provimit profesional për ushtrimin e veprimtarive për broker në sigurime ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut " nr. 47/2019 dhe 35/2020 dhe 280/2020).

Kandidatët që kanë kaluar me sukses provimin profesional për broker do të marrin Certifikatë për dhënien e provimit profesional për broker.

Kandidatët që tre herë me rradhë nuk e japin provimin profesional për broker do të humbasin të drejtën për dhënien e provimit për të cilin është parashikuar trajnimi.

SHËNIM:

Për shkak të kapaciteteve të kufizuara për mbajtjen e provimit profesional, numri i kandidatëve për pjesëmarrje në trajnim, përkatësisht dhënien e provimit është i kufizuar, kështu që regjistrimi do të bëhet sipas parimit kërkesa e parë –miratohet e para.

Aplikimet/kërkesat për pjesëmarrje në trajnim dhe mbajtjen e provimit profesional që do të paraqiten pas plotësimit të numrit maksimal të mundshëm të kandidatëve, si dhe aplikimet / kërkesat që do të paraqiten pas afatit të fundit për paraqitjen e tyre, nuk do të merren në konsideratë.

AGJENCIA E MBIKËQYRJES SË SIGURIMEVE



АГЕНЦИЈА ЗА
СУПЕРВИЗИЈА НА
ОСИГУРУВАЊЕ
AGJENCIA E
MBIKËQYRJES
SË SIGURIMEVE

тел/tel: 02 3254 050

факс/faks: 02 3290 240

адреса/adresa: ул.Македонија 66,
Палата Лазар Поп Трајков 5-ти кат,
1000 Скопје,
Република Северна Македонија/
rr.Makedonija Pa Nr
Pallati Llazar Pop Trajkov, kati i 5-të
1000 Shkup,
Republika e Maqedonisë së Veriut

e-mail: contact@aso.mk
www.aso.mk

